



PROJEKTI SEMP NDRIÇIMI RRUGOR NË SHQIPËRI




Ndriçim inteligjent: SEMP mbështet modernizimin e ndriçimit rrugor në Shqipëri

Projekti i Bashkive me Përdorim Inteligjent të Energjisë (SEMP) mbështet bashkitë shqiptare në menaxhimin e energjisë në mënyrë të qëndrueshme dhe në zbatimin e politikave kombëtare të energjisë dhe klimës në nivel lokal. Për të treguar përfitimet e efikasitetit të energjisë, u realizua modernizimi i ndriçimit rrugor duke zëvendësuar llambat me natrium me presion të lartë (HPS) dhe teknologjitë e tjera më pak efikente me teknologjinë LED (Diodë Ndriçuese).

Modernizimi u mbështet nga projekti SEMP në katër bashki pilot, konkretisht në **Berat, Korçë, Përmet dhe Shkodër**. Totali i këtij investimi për të katërta bashkitë është rreth 200 milion lekë.


Ndriçimi rrugor LED në 4 bashkitë pilot me një vështrim të shpejtë:



Bashkia Berat

Rezultatet e projektit:

Futja e ndriçimit LED (Gjatësia totale e rrugëve): 3.54 km
Konsumi vjetor i energjisë para ndërhyrjes: 155 MWh/vit
Kursimi vjetor i energjisë: 107 MWh/vit
Reduktimi i shkarkimeve të gazeve serrë: 41 ton CO₂ eq/vit



Bashkia Korçë

Rezultatet e projektit:

Futja e ndriçimit LED (Gjatësia totale e rrugëve): 10.57 km
Konsumi vjetor i energjisë para ndërhyrjes: 228 MWh/vit
Kursimi vjetor i energjisë: 137 MWh/vit
Reduktimi i shkarkimeve të gazeve serrë: 45 CO₂ ton eq/vit



Bashkia Përmet

Rezultatet e projektit:

Futja e ndriçimit LED (Gjatësia totale e rrugëve): **9.25 km**
 Konsumi vjetor i energjisë para ndërhyrjes: **92 MWh/vit**
 Kursimi vjetor i energjisë: **64 MWh/vit**
 Reduktimi i shkarkimeve të gazeve serrë: **24 ton CO₂ eq/vit**



Bashkia Shkodër

Rezultatet e projektit:

Futja e ndriçimit LED (Gjatësia totale e rrugëve): **6.88 km**
 Konsumi vjetor i energjisë para ndërhyrjes: **518 MWh/vit**
 Kursimi vjetor i energjisë: **369 MWh/vit**
 Reduktimi i shkarkimeve të gazeve serrë: **140 ton CO₂ eq/vit**

Cilat janë përfitimet e modernizimit të ndriçimit rrugor në bashkitë shqiptare?

- Financiare dhe Ekonomike** ➤ Kursimet vjetore të kostos së energjisë elektrike mund të përdoren për nisma të tjera zhvillimore të bashkive.
- Mjedisore** ➤ Reduktimi i shkarkimeve të gazeve serrë kontribuon në përpjekjet për zbutjen e ndryshimeve klimatike.
- Sociale** ➤ Përmirësimi i ndriçimit rrugor rrit sigurinë dhe kontribuon në krijimin e komuniteteve më miqësore me mjedisin.
- Ndërtimi i Kapaciteteve** ➤ Bashkitë morën trajnim mbi përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe specifikimeve sipas ligjit shqiptar të prokurimit publik.
- Vizioni Afatgjatë** ➤ Përvoja dhe njohuritë e fituara nga këto projekte pilot do të informojnë dhe udhëheqin projektet e ardhshme të eficiencës energjetike të identifikuara brenda Planeve të Veprimit për Energji dhe Klima të Bashkive.
- Rritja e Ndërgjegjësimit** ➤ Sistemet e ndriçimit LED janë diçka e dukshme dhe qytetarët mund ta ndiejnë dhe ta shohin ndikimin, pasi është diçka e prekshme.
- Ndikimi i Përgjithshëm** ➤ Projekti SEMP po nxit zbatimin e plotë të sistemeve të menaxhimit të energjisë në bashki, duke hapur rrugën për një të ardhme më të qëndrueshme dhe me efikasitet energjetik për Shqipërinë.

Çfarë është Projekti i Bashkive të Energjisë së Zgjuar (SEMP)?

SEMP është një projekt i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe i Agjencisë Kombëtare të Eficiencës së Energjisë (AEE) i mbështetur nga Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO).



Schweizerische Eidgenossenschaft
 Confédération suisse
 Confederazione Svizzera
 Confederaziun svizra

State Secretariat for Economic Affairs SECO



AEE Agjencia për Eficiencën e Energjisë